UDHËZIM
Nr. 2, datë 8.7.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 6.5.2019 "PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SË NDARJES SË KUOTAVE VJETORE TË IMPORTIT TË SUBSTANCAVE TË KONTROLLUARA

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 35 dhe të nenit 70, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, dhe të pikës 1, të kreut VI, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 9.1.2019 "Për miratimin e rregullave për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve që përmbajnë këto substanca",

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 1, datë 6.5.2019 "Për përcaktimin e mënyrës së ndarjes së kuotave vjetore të importit të substancave të kontrolluara", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 12 ndryshon si më poshtë:

"Autorizimi për pajisje me kuotë importi të substancave ozonholluese është i vlefshëm nga data e miratimit të tij deri në datën 31 dhjetor të çdo viti kalendarik. Një kopje të autorizimit "Kuotë importi të substancave të kontrolluara", Ministria ia përcjell Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave".

2. Në paragrafin e dytë, të pikës 2 (dy), të shtojcave 1/a dhe 1/b të këtij udhëzimi, togfjalëshi "Numri i Kodit të Regjistrimit të Importuesit (kodi UNIK)", hiqet.

3. Pika 11 e shtojcës 1/a të këtij udhëzimi, ndryshon si më poshtë:

"Autorizimi për pajisje me kuotë importi të substancave ozonholluese është i vlefshëm nga data e miratimit të tij deri në datën 31 dhjetor të çdo viti kalendarik".

4. Autorizimet e miratuara për vitin kalendarik 2020 janë të vlefshme deri në fund të vitit kalendarik.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Blendi Klosi